



## Nese je i huaj

### 10 rregullat per ndihme mjekesore per emigrantet

1. Nese je i huaj (vjen nga nje vend jashte Komunitetit Evropian) dhe ke nje leje qendrimi te rregullt per: pune, arsye familjare, azil politik, azil humanitar, kerkese per azil, ne pritje per adoptim,, marrje nenshtetesisie, duhet te regjistrohesh ne Sherbimin Shendetesor Kombetar (Ssn, dmth sistemin e sherbimit shendetesor publik). Eshte nje e drejte/detyre qe mbron shendetin tend!
2. Duke u regjistruar fiton te njejtat te drejta e detyra qe kane qytetaret italiane: keshtu mund te zgjedhesh mjekun tend familjar (te cilit mund ti drejtohesh per probleme jo te renda dhe urgente), ose te besh te gjitha vizitat dhe kontrollet e specializuara, ose te shtrohesh ne spital dhe te marresh ilace per kurim. Ne disa raste do te duhet te paguash, si qytetaret e tjere italiane, nje pjese te sherbimit mjekesor.
3. Sherbimi eshte i garantuar edhe per familjaret e tu ne ngarkim (bashkeshorte, bashkshort, femije, vellezer ose motra, prinder etj.) ,nqs i ke me qendrim te rregullt ketu ne Itali.
4. Per t'u regjistruar duhet te drejtohesh tek qendra shendetesore locale (ASL) e qytetit, zones ose lagjes ku ke vendbanimin (ajo e specifikuuar tek leja e qendrimit). Per t'u regjistruar mjaftojne leja e qendrimit, kodi fiskal dhe ne qofte se e ke certificata e vendbanimit (qe mund te zevendesohet edhe nga nje deklarate e shkruar nga avete ti mbi vendbanimin e zakonshem ).Kur te shkosh qe te regjistrohesh, duhet te zgjedhesh mjekun familjar mes atyre qe jane ne listen e ASL: pergatitu perpara! Nqs ke femije, duhet te zgjedhesh pediatrin e tyre! Regjistrimi ne ASL vlen deri kur te kete skaduar leja e qendrimit. Kur te prezantosh kerkese per rinovim te lejes se qendrimit, kujtohu qe te paraqesesh vertetimin qe te kane leshuar per rinovim tek zyrat e ASL, perndryshe rrezikon te hiqesh nga lista!
5. Ne qofte se je nje student ose ke nje leje qendrimi te rregullt per motive te ndryshme, per shembull, vendbanim i perzgjedhur ose per motive fetare, ke dy mundesi:ose te kesh nje sigurim shendetesor te njohur (dmth te konsideruar te vlefshem) ne Itali, kunder rrezikut te semundjeve e fatkeqesive dhe per mbrojtjen e shtatzanise, ose te regjistrohesh ne Ssn (regjistrim vullnetar) duke paguar nje kuote fikse vjetore:informohu tek ASL. Me regjistrimin vullnetar tek Ssn mund te jene te ndihmuar edhe femijet e tu, nsq ke; ky regjistrim ka vlefshmeri vjetore keshtu qe duhet te rinovohet.

- 6 Ne qofte se ke nje leje qendrimi per nje kohe te shkurter, per shembull per biznes ose per turizem, duhet te kesh nje sigurim privat, ose duhet te paguash plotesisht te gjitha mjekimet dhe sherbimet e perfituara.
- 7 Edhe ne qofte se nuk ke nje leje qendrimi te vlefshme (te ka skaduar dhe nuk te eshte rinovuar ose nuk e ke marre asnjehere) por ke probleme shendetsore te rendesishme, Ssn taliane te jep mundesine qe te kurohesh, si ne qendren shendetsore ashtu edhe ne spital, me nje karte ose kod i quajtur "STP". Dmth vlen vecanerisht per grate shtatzena ose te bera nena, femijet ose personat qe kane nje semundje infektuese. Eshte e rendesishme qe ti te kerkosh ndihme prane strukturave shendetesore publike ne qofte se nuk ndihesh mire, edhe per te mbrojtur personat e tjere qe mund te semuren. Kujtohu qe shpesh ka dhe shoqata vullnetare qe mund te ndihmojne.
- 8 Nqs je i varfer nuk duhet te paguash mjekimet dhe strukturat, por te kontribosh vetem me nje pjese te vogel te shpenzimeve (ticket - bileta) vetem kur te jete e parashikuar si per te huajt dhe per italianet.
- 9 Edhe nqs je klandestin, nuk duhet te kesh frike te shkosh tek mjeku ose ne spital: ligji italian ndalon qe te te denoncoje ne polici per faktin se nuk ke lejen e qendrimit; detyra e mjekeve, e infermiereve eshte e gjithe organizimit eshte ne fakt vetem te ndihmojne te semurin.
- 10 Ne qofte se je akoma jashte shtetit e do qe te vish ne itali per t'u kuruar duhet qe me perpara te kesh nje vize hyrje dhe nje leje qendrimi per arsye shendetesore. Nuk eshte nje gje e lehte, sepse per te patur nje vize te tille, duhet te paraqitesh nje dokument te vecante (informohu tek perfaqesia konsullore e vendit tend). Ne vecanti duhet te paguash tek struktura shendetesore qe do te te kuroje nje depozite qe mbulon 30% te shpezimeve te parashikuara. Duhet te jesh ne gjendje te paguash gjitha kurat dhe shpenzimet e riatdhesimit, dhe te kesh ne Itali per te gjithe periudhen e kurimit ,mundesi per strehim dhe ngrenie, per vete dhe per shoqeruesin tend!

